



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

UDHËZIM

Nr. 07 , datë 20.11.2025

PËR

MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË MEDIAN E SHKRUAR,
ELEKTRONIKE DHE/OSE AUDIOVIZIVE SI DHE PËRJASHTIMET PËR
QËLLIMET E POSAÇME TË PËRPUNIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 43, nenit 85, dhe pikës 2 të nenit 97 të ligjit nr.124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

U D H Ë Z O N:

KREU I

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NË MEDIA

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave për median e shkruar, elektronike dhe/ose audiovizive, publike ose private (në vijim “Media”) me qëllim për të garantuar përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe përcaktimi i rasteve kur aplikohen përjashtimet nga dispozitat e Ligjit në përpunimin e të dhënave nga kontrollues që realizojnë veprimtari në fushën e gazetarisë.

Neni 2

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë Udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 5, të Ligjit. Shtohen në këtë Udhëzim edhe përkufizimet e mëposhtme:

- a) “Publikimi” është vënia në dispozicion e materialit tek një person tjetër, për botim nga ky i fundit.

- b) “Gazetar” është çdo person që mbledh, përpunon, prodhon ose shpërndan informacion përmes mjeteve të komunikimit publik me qëllim informimin e publikut, në përputhje me parimet etike dhe profesionale të gazetarisë.
- c) “Redaktor” është çdo person që ushtron kontroll mbi përzgjedhjen/përpunimin e përmbajtjes së materialeve të destinuara për botim nga media elektronike, e shkruar, vizive dhe/ose audiovizive.
- ç) “Arkiv i gazetarëve” është tërësia e materialeve të mbledhura, përpunuara dhe ruajtura nga një gazetar/media në funksion të veprimtarisë së gazetarisë/medias për qëllime dokumentimi.
- d) “De-indeksim” është procesi përmes të cilit një informacion hiqet nga lista e rezultateve të kërkimit, një lidhje (link) që përmban të dhëna personale, në mënyrë që ajo të mos shfaqet më kur kërkohen informacione për një person të caktuar nëpërmjet emrit të tij.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Gazetari, redaktori dhe botuesi i medias, duhet të zbatojnë të gjitha dispozitat e Ligjit dhe këtij udhëzimi.
2. Media duhet të kujdeset që të mos publikojë informacione të paqarta, të pavërteta, përfshirë edhe imazhe që cenojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave. Në momentin kur konstatohet një gabim, pasaktësi apo deklaratë e pavërtetë, duhet të procedohet me korrigjimin e menjëhershëm¹. Në media, duhet të bëhet i qartë dallimi midis fakteve reale, komentit, opinionit dhe hamendësimit².
3. Të dhëna personale sensitive që zbulojnë origjinën racore/etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi, mund të përpunohen në rast se zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore e të interesave të subjekteve të të dhënave e me qëllim informimin mbi çështje me interes publik, vetëm nëse zbatohet parashikimi i germës e), të pikës 2, të nenit 9, të Ligjit.³ Në mënyrë alternative, bazuar në përjashtime të tjera specifike të parashikuara në të njëjtin nen dhe duke zbatuar në çdo rast rregullat e nenit 43 të Ligjit, media duhet të respektojë gjithmonë thelbin dhe aktualitetin e informacionit, duke shmangur referimet ndaj të afërmeve apo individëve të tjerë apo të dhëna që nuk kanë lidhje me informacionin.
4. Të dhënat sensitive⁴ mund të përpunohen nga media vetëm me pëlqimin e subjektit të të

¹ Neni 15 i Ligjit, parashikon si një nga të drejtat e subjektit të të dhënave edhe të drejtën për korrigjim dhe fshirje. Shih gjithashtu, pikën 1, faqja 5 të Kodit të Etikës së Gazetarit të hartuar me mbështetjen e projektit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe Median në Evropën Jug-Lindore (JUFREX)”.

² Pika 2, faqe 7 e Kodit të Etikës së Gazetarit.

³ Në pikën 1, të nenit 9 të Ligjit parashikohet se si rregull të dhënat sensitive nuk përpunohen, me përjashtim të rasteve kur përmbushet një nga kriteret e përcaktuara në pikën 2, të po këtij neni. Në rastin e përpunimit të të dhënave sensitive nga gazetarët germa e) citon: “është i nevojshëm për përmbushjen e një interesi publik thelbësor bazuar në legjislacionin në fuqi, i cili është proporcional me qëllimin e ndjekur, respekton thelbin e së drejtës së mbrojtjes së të dhënave”.

⁴ Të dhënat personale, të cilat mund të shfaqin bindje racore, etnike, besimet fetare, filozofike apo të tjera, mendimet politike, anëtarësimin në parti, sindikata, shoqata ose organizata fetare, në jetën filozofike ose juridike, si dhe të dhënat e gjendjes shëndetësore dhe orientimit seksual. Parashikuar në pikën 28, të nenit 5 të Ligjit.

- dhënave personale. Pëlqimi nuk është i nevojshëm kur ekzistojnë rastet e kufizimeve të parashikuara në nenin 43 të Ligjit, veçanërisht sa i përket përmbushjes së një interesi publik.
5. Gjatë raportimit mbi ngjarje që përfshijnë aksidente, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga njeriu, dhunë ndaj individëve, konflikte të armatosura ose skena vdekjeje, media ka përgjegjësinë të balancojë interesin publik për informim, me të drejtën e individëve për privatësi dhe dinjitet. Raportimi i plotë dhe i saktë nuk duhet të justifikojë cenimin e panevojshëm ose joproporcional të privatësisë së personave të përfshirë në ngjarje, që kanë të bëjnë me vujtje, dhimbje ose tragjedi.
 6. Media duhet të vlerësojë me kujdes justifikimin për qëllime gazetarie mbi përfshirjen e materialeve vizuale grafike ose invazive⁵. Vendimi për të publikuar pamje të tilla duhet të merret vetëm pasi të jenë shqyrtuar rrethanat konkrete dhe pasojat e mundshme për individët e përfshirë, si dhe ndikimi në të afërmit apo komunitetin më të gjerë.
 7. Në raste emergjence ose fatkeqësi ku ekipet e medias arrijnë në vendngjarje, nën presionin e kohës dhe të situatës mund të ndodhë që të regjistrohet material në mënyrë të gjerë në pamundësinë e menjëhershme për të vlerësuar ndikimin në privatësi. Megjithatë, përpara çdo transmetimi apo publikimi të mëtejshëm të këtyre pamjeve, nga media duhet të bëhet një vlerësim i kujdesshëm për të shmangur ekspozimin e panevojshëm të vujtjes, dhunës dhe cenimin e privatësisë së individëve⁶.

Neni 4

Familja, banesa, prona private

1. Çdo person ka të drejtë t'i respektohet jeta e tij/saj private dhe familjare, prona, shëndeti fizik e mendor dhe korrespondenca, duke përfshirë edhe komunikimin digjital.
2. Media nuk mund të ndërhyjë në jetën private të individit, pa pëlqimin e tij.
3. Nuk lejohen të publikohen imazhe të individit në vende private⁷, pa pëlqimin e tij.
4. Anëtarët e familjes, veçanërisht fëmijët, të afërmit dhe miqtë e figurave publike, të cilët vetë nuk janë figura publike, gëzojnë një nivel më të lartë të mbrojtjes së privatësisë. Vetëm në raste të veçanta, raportimi mediatik për ta mund të justifikohet nëse ekziston interes publik.
5. Adresa e banimit të një personi përbën të dhënë personale dhe, si e tillë, është e mbrojtur nga Ligji. Në parim, ajo nuk duhet të publikohet nga media nëse nuk ka një interes publik.
6. Media në asnjë rast nuk mund të cenojë banesën, apo të mbledhë imazhe nga një ambient privat, spitalor apo institucion i vujtjes së dënimit nëpërmjet kamerave, pa pëlqimin e personit. Mbrojtja e pronës dhe e ambienteve private shtrihet edhe në vende të tjera të kujdesit, ndalimit ose rehabilitimit, në përputhje me Ligjin duke përdorur në mënyrë korrekte teknikat ndërhyrëse.

⁵“Invazive”, në kontekstin mediatik ose etik (si p.sh. “materiale grafike ose invazive”), mund të jetë: **ndërhyrëse** ose **cenuese**. Në varësi të kontekstit, **shqetësuese** (kur flitet për përmbajtje që ngjall tronditje emocionale), **të ekspozuara më tepër** (për përmbajtje që zbulojnë më shumë se sa është e nevojshme).

⁶ Praktikë e mirë mund të jetë, shmangia e identifikimit të viktimave pa pëlqimin e familjarëve; errësimi i fytyrave, mosshfaqja e plagëve apo e trupave pa jetë, si dhe shmangia e komenteve që gjenerojnë reagime emocionale ose nxitje të mëtejshme të dhunës, vujtjes, etj.

⁷ “Vendet private” janë pronë publike ose private, ku ekziston një besim i arsyeshëm për intimitetin.

7. Në rastin kur gazetarët mbledhin informacione nga institucione publike dhe private⁸ duhet të vlerësojnë, duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, se cilat informacione mund të cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e subjekteve të të dhënave, për të mos i publikuar. Në çdo rast, përgjegjësia e balancimit të interesave bie mbi redaktorin dhe median që publikon të dhënat.

Neni 5

Mbrojtja e të miturit⁹

1. Të miturit janë subjektet më të prekura ndaj rrezikut të cenimit të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Media duhet të mbajë parasysh që:
 - a) të miturit duhet të jenë të lirë për të përfunduar aktivitetin shkollor, pa ndërhyrje të panevojshme në të dhënat e tyre personale;
 - b) fëmijët nën moshën 16 vjeç nuk duhet të intervistohen ose fotografohen, për çështje që përfshijnë mirëqenien (mbarëvajtjen) e tyre ose të një fëmije tjetër, vetëm kur prindi /kujdestari ligjor jep pëlqimin;
 - c) nxënësit nuk duhet të fotografohen apo intervistohen, në ambientet e shkollës pa siguruar më parë lejen e autoriteteve shkollore;
 - ç) media duhet të shmang publikimin e informacionit që ka lidhje me të dhënat personale të fëmijëve të figurave publike nëse informacioni nuk kontribuon në një debat me interes publik.
2. Me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, media ndalohet të publikojë gjeneralitetet, imazhet e të miturit, si dhe çdo të dhënë që mund të çojë në identifikimin e tij gjatë përfshirjes në një ngjarje kriminale. Mbrojtja e privatësisë së të miturit të përfshirë në një ngjarje kriminale garantohej në mënyrë proporcionale dhe rast pas rasti, duke vlerësuar ngjarjen në raport me interesin publik.
3. E drejta e fëmijës për ruajtjen e konfidencialitetit mbizotëron në raport me lirinë e shprehjes dhe publikimin e informacionit. Nëse, për arsye të një interesi publik dhe pa cenuar kufijtë ligjorë, media vendos të zbulojë informacione ose imazhe që kanë të bëjnë me të mitur, ajo duhet të ketë në konsideratë parësore, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe të mos tejkalojë parashikimet e Kodit të Etikës së Gazetarit.
4. Media nuk duhet të identifikojë të miturit, të cilët janë viktimat ose dëshmitarë në rastet e krimeve seksuale.
5. Në çdo komunikatë për shtyp të një rasti që përfshin një krim seksual kundrejt një të mituri, duhet të shmanget zbulimi i marrëdhënies mes autorit dhe të miturit.
6. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të të miturit, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast abuzimi ndaj tij, është parësore në krahasim me lirinë e shprehjes dhe publikimin e informacionit. Kjo vlen edhe në rastin kur identiteti bëhet i ditur nga burime zyrtare apo pranë familjes. Media nuk duhet të identifikojë viktimat e sulmeve seksuale apo të botojë materiale që mund të çojnë në identifikim direkt ose indirekt të tyre.

⁸ Për shembull: farmacistë mbledhin të dhëna personale të pacientëve dhe receta të lëshuara nga mjekët, bankat për klientët e tyre, kompanitë e sigurimit, kompanitë telefonike, policia etj.

⁹ Shih ITA ER. neni 7 - Tutela del minore, dhe “*Carta di Treviso e Testo Unico dei Doveri del Giornalista*” në fuqi që nga 1 janari 2021 dhe Aneksi 1 i tij “*Regole deontologiche relative al trattamento dei dati personali nell’esercizio dell’attività giornalistica*”.

7. Publikimi i të dhënave që lidhen me birësimin e të miturit, pa pëlqimin e prindit birësues, është i ndaluar. Përjashtim përbën rasti kur publikimi i të dhënave i të miturit të birësuar apo birësuesit vjen në interesin më të lartë të fëmijës.
8. Media duhet të garantojë anonimitetin e të miturit i cili është i përfshirë në një procedurë juridike, sidomos në çështje të natyrës familjare apo në raste të tjera delikate për shëndetin psikosocial të të miturit.
9. Media duhet të ketë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, duke vlerësuar rast pas rasti marrëdhënien faktike që ka prindi me fëmijën, kryesisht sa i përket ushtrimit të drejtë të përgjegjësisë prindërore¹⁰. Informacionet e marra nga prindërit mund të publikohen vetëm kur shërbejnë në interesin më të lartë të fëmijës.
10. Nuk duhet të përdoren të miturit e sëmurë me patologji të rënda për qëllime propagandistike ose për çdo arsye tjetër që është në kundërshtim me të drejtat e tyre.
11. Nuk lejohet intervistimi i të miturit i cili ndodhet në kushtet e një gjendje të rëndë psikologjike¹¹ edhe nëse intervista paraqet interes publik. Të miturit nuk duhet të marrin pjesë në programet mediatike që trajtojnë dhe diskutojnë rreth ngjarjeve që shkaktojnë ngarkesë emocionale.
12. Media duhet të kërkojë pëlqimin e prindit apo kujdestarit ligjor për të intervistuar të miturit ose për t'i përfshirë ata në aktivitetet e tyre mediatike. Përjashtim mund të bëhet vetëm kur të miturve u jepet mundësia të flasin për tema që nuk janë të ndjeshme, dhe kur është e qartë që ata mund të shprehin pikëpamjet e tyre pa nevojën e pëlqimit të prindit/kujdestarit ligjor. Megjithatë, në çdo rast duhet mbajtur në konsideratë kundërshtimi i prindit/kujdestarit ligjor mbi informacionin e mbledhur përpara dhe nëse është publikuar pas publikimit.

Neni 6

Mbrojtja e të dhënave në procedimet penale

1. Përpunimi i të dhënave me qëllim për të zbuluar masat e sigurimit personal të caktuara ndaj personave të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, lejohet vetëm kur ky përpunim është në përmbushje të interesit publik.
2. Në publikimin e informacionit të lidhur me një fakt penal, ndalohet identifikimi i personave të afërt me autorin e dyshuar ose të dënuar për kryerjen e veprës penale, me përjashtim kur këta të fundit kanë dhënë pëlqimin.
3. Me përjashtim të rasteve kur informacioni përbën interes publik, media nuk merr as prodhon imazhe të personave të ndaluar dhe/ose të arrestuar. Personat nuk duhen filmuar në kushtet e privimit të lirisë nga ana e organeve të rendit, përveç nëse kjo është e nevojshme për të raportuar veprime arbitrare nga organet e rendit.¹²
4. Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Media, në publikimin e një fakti penal, ka detyrimin të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë.
5. Gjatë përpunimit për qëllime gazetarie të të dhënave personale që lidhen me persona të

¹⁰ Fëmija mund të jetë viktimë.

¹¹ Për shembull kur të miturit janë larguar nga banesa, kanë qenë viktimë të krimit të organizuar apo janë përdorur për prostitucion, etj.

¹² Shih nenin 8 Rregulla Etike ITA

dyshuar për kryerjen e një vepre penale, persona të dënuar ose me subjekte të tjera të përfshira në një procedim penal, media ka detyrimin të respektojë të drejtën e tyre për një jetë private. Në mënyrë të veçantë kjo mbrojtje u garantohet të miturve, viktimave, dëshmitarëve, si dhe familjarëve të personave të dyshuar për kryerjen e një vepre penale ose të dënuar për kryerjen e një vepre penale.

6. Media mban në vëmendje pasojat e dëmshme që mund t'u vijnë personave të sipërpërmendur si rezultat i publikimit të informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të tyre.

Neni 7

Përdorimi aparaturave për regjistrim

1. Media nuk duhet të përpunojë të dhëna personale apo të botojë/publikojë materiale të siguruar nga përdorimi i kamerave/pajisjeve të tjera të fshehta, apo nga thirrje private ose telefon celular, mesazhe/e-mail, ose nëpërmjet përdorimit të paautorizuar të dokumenteve dhe imazheve që përmbajnë të dhëna personale, përveç rasteve kur mbizotëron interesi publik.
2. Ndalohej publikimi tërësisht ose pjesërisht i dokumenteve të klasifikuara apo të konsideruara të tilla në kuptim të legjislacionit specifik në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Media gëzon të drejtën për të informuar mbi çështje me interes publik, por kjo e drejtë duhet ushtruar duke respektuar përmbajtjen thelbësore të informacionit, proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë e publikimit, pa cenuar kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm.
3. Publikimi i përmbajtjes së përgjimeve mund të konsiderohet proporcional nëse:
 - a) ndihmon në kuptimin e rrethanave të veçanta në të cilat ka ndodhur ngjarja dhe nuk tejkalon kufijtë e nevojshëm në raport me qëllimin informues dhe interesin publik të arsyeshëm;
 - b) nuk cenon asnjë dispozitë të legjislacionit në fuqi dhe hetimet paraprake apo gjykimin e një procedimi në zhvillim.Në çdo rast, publikimi i materialeve të tilla duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore të personave të përfshirë, bazuar në balancimin midis lirisë së shprehjes me mbrojtjen e jetës private.
4. Nuk lejohet publikimi i përmbajtjeve të përgjimeve që përfshijnë aspekte të jetës private që nuk lidhen me ngjarjen që përbën interes publik, veçanërisht të dhëna që kanë të bëjnë me intimitetin, marrëdhëniet familjare, shprehjet personale apo orientimin seksual të personave të përfshirë. Çdo tejkallim i këtyre kufijve përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe të minimizimit të të dhënave, siç përcaktohet në Ligj dhe cenon të drejtën për jetë private të individëve të përfshirë.
5. Publikimet e pafiltruara mund të sjellin keqkuptime në interpretimin e fakteve apo marrëdhënieve ndërpersonale, si dhe të cenojnë të drejtën për privatësi, dinjitetin dhe zhvillimin e hetimeve penale.
6. Media gëzon të drejtën për të informuar mbi çështje me interes publik, por kjo e drejtë duhet ushtruar duke respektuar përmbajtjen thelbësore të informacionit, proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë e publikimit.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave shëndetësore

1. Të dhënat shëndetësore konsiderohen të dhëna sensitive dhe nuk mund të publikohen pa pëlqimin e subjektit, përveç rasteve kur personi nuk mund të identifikohet. Media ka detyrimin të respektojë dinjitetin dhe privatësinë e individit, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, duke shmangur publikimin e detajeve të panevojshme. Publikimi i informacionit lejohet vetëm kur është i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të informimit dhe gjithmonë duke ruajtur dinjitetin e personit, në përputhje me kufizimet e pikës 1 të nenit 10 të këtij udhëzimi, për individët me rëndësi të veçantë shoqërore ose publike.
2. Nuk lejohet publikimi i të dhënave të përfthuara nga analizat dhe ekzaminimet shëndetësore, të cilat mund të tregojnë të dhëna sensitive mbi shëndetin. Ky publikim lejohet vetëm kur ndjek thelbin e informacionit dhe gjithmonë duke respektuar dinjitetin e personit.

Neni 9

Publikimi i imazheve

1. Gjatë dokumentimit me imazhe të fakteve të kronikës të cilat ndodhin në vende publike, media përpara publikimit të materialit duhet të vlerësojë se çfarë lloj fokusimi duhet përzgjedhur, duke shmangur fokusimin e pamjeve vetëm mbi individët apo tek detaje të personave, nëse përhapja e këtyre të dhënave nuk rezulton se ka lidhje ose e tejkalon qëllimin e kronikës.
2. Imazhet të cilat janë ekspozuar gjatë një konference për shtyp të mbajtur nga forcat e policisë apo të marra në mënyrë ligjore, nuk mund të shpërndahen, përveç se në ndjekjen e qëllimeve specifike për të cilat janë mbledhur në fillim (verifikim, parandalim ose ndalim të kryerjes së veprave penale).
3. Imazhet që dokumentojnë veprimet e arrestimit nuk mund të shpërndahen kur dëmtojnë dinjitetin e personit. Ndalohet riprodhimi i imazheve të personave të ndaluar, përveç kur kjo është në funksion të interesit publik. Faktet e tjera si ato që i përkasin arrestimit, hetimit dhe procesit (për shembull, imazhet e marra nga dokumentet e identifikimit, albumet familjare apo atyre të marra në seancë gjyqësore), duhet të përdoren në mënyrë të ligjshme dhe korrekte. Përhapja e imazheve të cituara më sipër kryhet vetëm pasi është bërë një vlerësim për të dhënë vetëm thelbin e informacionit, në lidhje me lajmin.
4. Çdo ndërhyrje teknike mbi një imazh, përmes montazhit, korrigjimit elektronik apo përpunimit digjital, duhet të realizohet në mënyrë që të mos cenojë jetën private dhe dinjitetin e individit.
5. Imazhet nuk duhet të ekspozohen apo të vihen në shitje, për sa kohë që ekspozimi ose tregtimi mund të cenojë jetën private dhe dinjitetin e individit.

Neni 10

Figura publike

1. Media duhet të respektojë jetën private të figurave publike.
2. Publikimi i të dhënave personale nga media në lidhje me figura publike lejohet vetëm në atë

masë që informacioni ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin publik, veprimtarinë institucionale apo ndikimin e tyre në jetën publike. Ky publikim duhet të respektojë parimet e proporcionalitetit dhe interesit publik, sikundër parashikohet në Ligj, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.

3. Ndalohe publikimi i informacioneve ose të dhënave që lidhen me jetën private të figurave publike, për sa kohë që këto të fundit nuk lidhen me aktivitetin publik të tyre.

Neni 11

Kuptimi i interesit publik

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, interesi publik lidhet me ato çështje, që prekin publikun në një shkallë të tillë sa që ai ka të drejtë legjitime të interesohet dhe të informohet, me qëllim të kuptimit më të mirë të tyre dhe formimit të opinionit për vendime mbi ngjarje me rëndësi publike, ose që e shqetësojnë atë në mënyrë domethënëse.
2. Çështje që konsiderohen me interes publik janë, por pa u kufizuar, ato që lidhen me:
 - a) ekspozimin e rasteve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me mbrojtjen e sigurisë publike;
 - b) mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit;
 - c) parandalimin, ekspozimin e rasteve që kanë lidhje me veprat penale, krimet e rënda, trazirat, skandalet apo sjelljet dukshëm antisociale;
 - ç) të drejtat dhe liritë e tjera themelore të njeriut;
 - d) keqpërdorimin e detyrës publike ose përdorimin e papërshtatshëm/abuziv të fondeve publike;
 - dh) parandalimin publik të mashtrimit dhe/ose manipulimit;
 - e) parandalimin e keqinformimit të publikut nga deklaratat ose veprimet e individëve ose organizatave;
3. Media, ndër të tjera, në përcaktimin e interesit publik, duhet të ketë parasysh nëse publikimi i informacionit është në gjendje të kontribuojë në një debat publik me interes të përgjithshëm shoqëror.
4. Një informacion konsiderohet se kontribuon në debatin publik me interes të përgjithshëm kur lidhet me çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në shoqëri, si funksionimi i institucioneve publike, ushtrimi i pushtetit, zbatimi i ligjit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, garantimi i transparencës dhe llogaridhënies, si edhe çështje në fushën shëndetësore, sociale, mjedisore ose ekonomike.
5. Informacioni që synon vetëm të kënaqë kuriozitetin ose të krijojë sensacion në publik për jetën private të individëve, nuk konsiderohet i përshtatshëm për publikim në kuadër të debatit publik me interes të përgjithshëm shoqëror, nuk lidhet me interesin publik dhe duhet shmangur me qëllim respektimin e të drejtës për privatësi dhe dinjitetin e personave të përfshirë.
6. Gazetarët dhe media duhet të vlerësojnë rast pas rasti, në mënyrë të balancuar dhe proporcionale, nëse përmbajtja e publikimit përmbush kriteret e interesit publik, duke marrë parasysh natyrën e informacionit, mënyrën e marrjes së tij, rrethanat e rastit, statusin publik të personave të përfshirë dhe ndikimin që publikimi mund të ketë në debatin publik me interes të përgjithshëm shoqëror.

Neni 12

Arkiva

1. Arkiva e gazetarëve/medias, e cila përdoret për ushtrimin e veprimtarisë profesionale dhe ndjekjen për qëllime gazetarie, gëzon mbrojtje të posaçme në lidhje me konfidencialitetin e burimeve të informacionit, në përputhje me Ligjin.
2. Gazetarët/mediat kanë të drejtë të ruajnë të dhënat personale të mbledhura vetëm për kohën që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin ato janë mbledhur, në përputhje me nenin 6 të Ligjit që parashikon parimin e kufizimit të afatit të ruajtjes.
3. Arkivat e gazetarëve/medias, përfshirë ato në formate fizike apo elektronike, përbëjnë burime me vlerë historike, sociale, shkencore dhe kulturore. Përpunimi i të dhënave personale që përfshihen në këto arkiva lejohet vetëm kur kryhet për qëllime historike, kërkimore, shkencore ose statistikore, në përputhje me nenin 45 të Ligjit duke marrë masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave.

KREU II

AFATET DHE KUSHTET PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMET PËRKATËSE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PËR QËLLIME GAZETARIE

Neni 13

E drejta për t'u harruar

1. Media gjatë përpunimit të të dhënave personale në funksion të ushtrimit të veprimtarisë për qëllime gazetarie, respekton edhe të drejtën e individit për t'u harruar, si një e drejtë për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale që nuk janë më të nevojshme, janë përpunuar në mënyrë të paligjshme ose që cenojnë jetën private dhe reputacionin e subjektit të të dhënave, në përputhje me Ligjin.
2. Kërkesa për të drejtën për t'u harruar mund të paraqitet nga subjekti i të dhënave kur:
 - a) informacioni i publikuar nuk është më i nevojshëm për qëllimet e gazetarisë për të cilat është mbledhur;
 - b) të dhënat kanë humbur vlerën aktuale për interesin publik dhe vijnë të kenë efekt negativ në jetën personale apo profesionale të individit;
 - c) informacioni është i pasaktë, i papërditësuar, i dëmshëm apo i panevojshëm në raport me kohën e kaluar nga ngjarja;
 - ç) subjekti i të dhënave ka ushtruar të drejtën për të tërhequr pëlqimin për përpunim, në rastet kur përpunimi është bazuar në pëlqimin e tij.
3. Media ka detyrimin të vlerësojë proporcionalitetin ndërmjet të drejtës për privatësi dhe të drejtës për liri të shprehjes dhe informim, duke marrë në konsideratë:
 - a) rolin publik të subjektit të të dhënave;
 - b) natyrën dhe ndjeshmërinë e informacionit të publikuar;
 - c) kohën e kaluar nga publikimi;
 - ç) qëllimin, formën dhe kontekstin e shpërndarjes së informacionit.
4. Kur informacioni është i disponueshëm online në arkivat e medias, masa për zbatimin e të drejtës për t'u harruar mund të përfshijë:

- a) fshirjen e informacionit;
 - b) anonimizimin e emrit apo të të dhënave identifikuese;
 - c) de-indeksimin nga motorët e kërkimit;
 - ç) shtimin e një përditësimi ose reference ndaj zhvillimeve të mëvonshme ligjore që kanë ndryshuar statusin e subjektit të të dhënave.
5. E drejta për t'u harruar nuk zbatohet ndër të tjera nëse informacioni:
- a) është i domosdoshëm për ushtrimin e së drejtës për liri të shprehjes dhe informimit;
 - b) ruan vlerë historike, shkencore ose hulumtuese për publikun;
 - c) është pjesë e një procesi penal apo gjyqësor në zhvillim ose që përfundon me një vendim përfundimtar të gjykatës;
 - ç) përmbush qëllime të interesit publik, përfshirë transparencën dhe llogaridhënien e figurave publike.
6. Në çdo rast, media është përgjegjëse për vlerësim objektiv dhe të paanshëm të kërkesave për fshirje dhe për marrjen e masave të arsyeshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Neni 14

Afatet dhe kushtet e përjashtimit

1. Veprimtaritë në fushën e gazetarisë konsiderohen si përpunime për qëllime të posaçme sipas Pjesës së II, të Kapitullit V, të Ligjit.
2. Kontrolluesi përjashtohet nga detyrime specifike në kuptim të Ligjit, kur përpunon të dhëna personale për publikimin e materialeve për qëllime gazetarie:
 - a) për përgatitjen e të cilave të dhënat në fjalë janë të domosdoshme për t'u përpunuar;
 - b) duke përpunuar të dhënat vetëm për qëllimin fillestar të parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;
 - c) pa cenuar thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave;
 - ç) kur ka një interes publik;
 - d) kur zbatimi i dispozitave të Ligjit e bën të pamundur arritjen e qëllimit.
3. Kur kontrolluesi mund të realizojë qëllimin e posaçëm edhe pa u bazuar në përjashtimet e përcaktuara në pikën më sipër, ai duhet të veprojë në mënyrën më pak ndërhyrëse në mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Kur kontrolluesi mbështetet në përjashtimet e nenit 43 të Ligjit, ai duhet t'i ruajë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa janë të nevojshme për të publikuar materiale për qëllime gazetarie. Këto të dhëna përhapen vetëm në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 43, të Ligjit.
5. Të dhënat personale mund të ruhen për periudha më të gjata vetëm për qëllime arkivimi dhe për sa kohë që ky përpunim është në shërbim të interesit publik dhe për qëllime kërkimore, shkencore, historike ose qëllime statistikore, duke iu nënshtruar zbatimit të masave të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi lejohet vetëm kur vjen në përputhje me pikën 3, të nenit 45 të Ligjit dhe pikën 3 të nenit 12 të këtij udhëzimi.

Neni 15

Informimi dhe sigurimi i pëlqimit

1. Gazetari/media që përpunon të dhëna personale, duhet të bëjë të njohur identitetin e tij si kontrollues, profesionin dhe qëllimin për të cilin mblidhet ky informacion, me përjashtim të rastit kur:
 - a) kjo sjell rrezik për sigurinë e tij ose;
 - b) njoftimi i subjektit e bën të pamundur ushtrimin e funksionit e tij.
2. Pas njoftimit të mësipërm, gazetarit nuk i kërkohet të përmbushë elementë të tjerë të informacionit të parashikuara në nenet 13 dhe 14, të Ligjit, në përputhje me përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të përcaktuar në nenin 6 dhe kufizimet e parashikuara në nenin 21, të Ligjit.

Neni 16

Bashkëpunimi

Gazetari/media, në cilësinë e kontrolluesit, ka detyrimin ligjor të bashkëpunojë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke i siguruar në këtë mënyrë gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave që i ngarkon Ligji.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit/përpunuesit publikë dhe privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e medias.
2. Mosrespektimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të Ligjit dhe sanksionohet sipas nenit 94, të tij.
3. Udhëzimi nr. 9/2010 *“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”*, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 31/2012 *“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”*, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi